

Krahasimi i gjendjes se shoqërive civile në Kosovë dhe Shqipëri

1. Hyrje

Shoqëria civile sot konsiderohet një ndër faktorët kryesor të forcimit demokratik të një vendi. Ata që preken nga një vendim politik, duhet të shprehin mendimin e tyre dhe ky është një parim demokratik. Kosova dhe Shqipëria janë dy shtete të Ballkanit Perëndimor, që pretendojnë t'i mbrojnë vlerat demokratike, dhe roli i shoqërisë në këto dy shtete është i një rëndësie jetike. Ky hulumtim është një analizë krahasuese e gjendjes aktuale të shoqërisë civile në Kosovë dhe në Shqipëri. Analiza është bazuar mbi tri raporte; raporti vjetor i USAID mbi zhvillimin e shoqërive civile, raporti i Komisionit Evropian dhe raporti analitik i indeksit të shoqërisë civile- CIVICUS. Përmes këtyre raporteve do të vihet në pah roli aktual i shoqërisë civile në Kosovë dhe Shqipëri, duke marrë parasysh faktin sa kanë ndikim ato në proceset politike të vendeve të tyre, se sa janë ato zëshme e sa të “pavarura” dhe cilat janë vështirësitë më të mëdha që ato hasin në zbatimin e detyrave të tyre.

Por, para se të vijmë deri tek analiza krahasuese, do duhej të definohej fillimisht koncepti “shoqëri civile” dhe rolin të cilin duhet ta ketë në demokraci. Ernest Gellner, shoqërinë civile e përkufizon si një grumbull i institucioneve të ndryshme joqeveritare i cili është mjaft i fuqishëm që ta balancojë shtetin.¹ Shoqëria civile, pra thjesht konsiderohet aktiviteti shoqëror i njerëzve jashtë familjes, shoqërisë, dhe vendeve të tyre të punës, dhe që nuk ka qëllime profitabile apo synime për pushtet. Ajo thjesht nënkupton vullnetin e përbashkët të njerëzve që t'i ndjekin interesat apo dëshirat e tyre.² Roli i tyre është shkëmbimi i informacionit, arritja e qëllimeve kolektive, formulimi i kërkesave të tyre drejtuar shtetit, përmirësimi dhe funksionimi i shtetit si dhe mbajtja e zyrtarëve përgjegjës ndaj obligimeve të tyre shtetërore. Shoqëria civile është një fenomen ndërmjetës, që qëndron mes sferës private dhe shtetit.³

¹ Gellner, Ernest. (2002) Konditat e Lirisë: shoqëria civile dhe rivalet e saj. Pejë: Dukagjini. Faqe, 37.

² Clark, John D. (2003) Worlds Apart: Civil Society and the Battle for Ethical Globalization. USA: Kumarian Press. Page: 92.

³ Diamond, Larry. (1997) Civil Society and the Development of Democracy. Estudio/Working Paper. Page: 7.

2. USAID – Indeksi i qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë civile ⁴

Raporti 2012 për Shqipërinë - Në raport thuhet se shoqëria civile shqiptare ka filluar të merr një pozicion më aktiv në çështjet kyçe të shqetësimeve publike. Kampanja ACT NOW – e iniciuar nga ambasada amerikane për forcimin e parimeve të demokracisë- inkurajon avokim qytetar dhe angazhime në terren nga Organizatat e Shoqërive Civile Shqiptare. Sipas këtij raporti, vendimmarrësit kanë injoruar tërësisht propozimet e OSHC-ve,⁵ për ta përmirësuar mjedisin ligjor për shoqërinë civile, ndërsa kapaciteti organizativ i OSHC-ve është përmirësuar paksa.⁶ Megjithëse, realizueshmëria financiare mbetet ende shqetësimi më serioz i shoqërisë civile sepse mungon një partneritet i koordinimit mes autoriteteve shtetërore, OSHC-ve, dhe komunitet të donatorëve në këtë çështje. Shumica e OSHC-ve përmbushin vetëm 10 deri 20% kërkesat e programeve të BE-së.⁷

Raporti vazhdon të identifikojë ngecjet tjera të shoqërisë civile shqiptare. Aty thuhet se konsultimi i shoqërisë në nivelin e qeverisë dhe parlamentit është sporadik dhe në masë të madhe i paefektshëm. Qeveria ka mungesa të procedurave standarde dhe të rregullave detyruese për t'u angazhuar në dialog me shoqërinë civile dhe akterët e tjerë jo-shtetëror. Vetëm pas presionit ndërkombëtar, qeveria bie dakord të konsultohet me shoqërinë civile. Kurse sa i përket dimensionit të imazhit, publiku shqiptar duket të jetë ende skeptik rreth shoqërisë civile, pjesërisht për shkak të mungesës së informacionit mbi rolin e Shoqërive Civile.⁸

Raporti 2012 për Kosovën- Pas zhvillimeve të larta të çështjeve politike në vitin 2012, kishte pak hapësirë për organizatat e shoqërisë civile që t'i avancojnë agjendat e tyre.⁹ Në raport përmendet incidenti me organizatën Kosovo 2.0, e cila kishte planifikuar të nisë revistën e saj të titulluar “Seksi dhe fokusi në çështjet e lezbikeve, homoseksualeve, biseksualeve dhe transgjjinore.”, por që u shkatërrua nga huliganet. Raporti e sheh si shqetësim dështimin e autoriteteve shtetërore për

⁴ Indeksi i OShC-ve për Europën qendrore e lindore & Euroazinë është një instrument vlerësues në lidhje me sektorin civile.

⁵ OSHC shkurtës për “Organizata të Shoqërisë Civile”.

⁶ Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC në Shqipëri, faqe 2. Shih: <http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/ALB.pdf>

⁷ Indeksi i i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC në Shqipëri, faqe 3.

⁸ Indeksi i i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC në Shqipëri, faqe 4-6.

⁹ Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC për Kosovën, faqe 2. Shih: <http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CS-KM.pdf>

të reaguat në mbrojtje të tyre. “Policia ka reaguat shumë ngadalë dhe institucionet qeveritare dhe elitat politike në masë të madhe dështuan po ashtu të reagojnë”.¹⁰

Një problem tjetër që del nga ky raport janë prioritetet e shoqërisë civile të cilat shpesh nuk pasqyrojnë prioritetet e publikut, ato në masë të madhe janë të izoluara nga publiku. Shqetësim tjetër me radhë është edhe aspekti financiar, vetëm 20% e fondeve të OSHC vijnë nga burimet lokale, dhe shumica e këtyre fondeve janë të dedikuara për aktivitete humanitare apo sponsorizimin e evenimenteve publike siç janë festivalet apo koncertet.¹¹

Po ashtu dhe në fushën e avokimit, shoqëria civile ka hasur në vështirësi të mëdha. Ndërsa sa i përket mundësisë së pjesëmarrjes në proceset e politikave, shumica e OSHC aktive kanë linja direkte me përfaqësues të institucioneve publike. Kjo kur kihet parasysh madhësinë e vendit, përfaqësues të këtyre organizatave kanë shpesh lidhje familjare me zyrtarët e lartë. Progresi në këtë raport gjendet në dimensionin e imazhit, ku mbështetja mediatike për OSHC në nivelin kombëtar dhe lokal është goxha pozitive dhe e bollshme. Përfaqësues të OSHC-ve janë të ftuar të emisione për të diskutuar, ato po ashtu shpesh i ftojnë ata edhe për dhënien e opinionit për tema të çështjeve të ndryshme.¹²

3. Raporti i Komisionit Evropian 2011 për Kosovën dhe Shqipërinë

Raporti i progresit i KE për Shqipërinë vë në pah se shoqëria civile shqiptare vuan nga mungesa e kooperimit dhe e kapaciteteve; shumica e organizatave mbeten të varura nga donatorët, duke çuar kështu në konkurrencën e tepruar për fonde në këtë sektor. Shoqëria civile ka qenë konsultuar për disa iniciativa legjislative, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut. Megjithatë sipas këtij raporti nuk ka dialog sistematik dhe konsultimi me OJQ-të në procesin legjislativ mbetet i pamjaftueshëm.¹³

Kurse sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, zhvillimi i organizatave të shoqërisë civile ka përparuar shumë pak. Të kuptuarit publik i rolit të shoqërisë civile mbetet i

¹⁰ Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC për Kosovën, faqe 3.

¹¹ Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC për Kosovën, faqe 4.

¹² Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC për Kosovën, faqe 5-6.

¹³ Raporti i progresit i KE për Shqipërinë 2011, faqe 17. Shih:
http://www.shqiptariitalise.com/images/al_rapport_2011_en.pdf

ulët, ndërsa është po ashtu brengosese që shoqëria civile i nënshtrohet presioneve politike të mëdha dhe kërcënimeve nëse aktivitetet e saj nuk përputhen me qëndrimet e autoriteteve. Mjedisi në të cilin OJQ-të veprojnë duhet përmirësuar. Qeveria, Kuvendi dhe komunat duhet të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive me shoqërinë civile, thuhet në raport.¹⁴

4. Krahasimi i raporteve analitike të indeksit të shoqërisë civile të CIVICUS

Raporti CIVICUS është i ndërtuar mbi pesë dimensione; Angazhimi qytetar, niveli i organizimit, praktikimi i vlerave, perceptimi i ndikimit dhe mjedisi i jashtëm. Angazhimi qytetar është dimension i parë i matur nga Indeksi i Shoqërisë Civile, dhe synon hulumtimin e shkallës së angazhimit të individëve në iniciativat shoqërore dhe politike. Rezultati i përgjithshëm i angazhimit qytetar në Kosovë që del nga ky raport është 44%,¹⁵ kurse në Shqipëri është pak më e madhe 47.6 %.¹⁶ Bazuar në të dhënat, vihen në përfundim se angazhimi qytetar është realisht një dimension i dobët si i shoqërisë civile kosovare ashtu edhe i shoqërisë civile shqiptare.

Dimensioni i nivelit të organizimit, përfshin ekzistimin e kushteve organizative që mundojnë zhvillimin funksional të një shoqërie civile. Ky dimension është më i larti i shoqërisë civile në Kosovë me 70.7% duke treguar se shoqëria civile kosovare karakterizohet me një shkallë solide të institucionalizimit.¹⁷ Në Shqipëri niveli i organizimit është më i ulët 57.9% megjithëse është një rezultat i kënaqshëm.¹⁸ Dimension i praktikimit të vlerave nënkupton shkallën në të cilën shoqëria civile praktikon disa vlera bazë. Në Kosovë praktikimi i vlerave ka rezultuar me rezultatin e dytë me të lartë prej 59.4 %.¹⁹ Kurse në Shqipëri arrin nivelin e 62.4%, duke përfaqësuar kështu vlerën më të lartë të të pesë dimensioneve të Indeksit të Shoqërisë Civile.²⁰

¹⁴ Raporti i progresit i KE për Kosovën 2011, faqe 17. Shih:

http://www.eas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf

¹⁵ Raporti Analitik i Kosovës i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus. (2011), faqe 23. Shih:

http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/KCSF_CIVICUS_ISHC_Raporti_Analitik_per_Kosove.pdf

¹⁶ Raporti Analitik Kombëtar i Indeksit të Shoqërisë Civile Civicus për Shqipërinë. (2010), faqe 12. Shih:

http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/csi_albania_acr_alb.pdf

¹⁷ Raporti Analitik i Kosovës i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus. (2011), faqe 27.

¹⁸ Raporti Analitik Kombëtar i Indeksit të Shoqërisë Civile Civicus për Shqipërinë. (2010), faqe 15.

¹⁹ Raporti Analitik i Kosovës i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus. (2011), faqe 32.

²⁰ Raporti Analitik Kombëtar i Indeksit të Shoqërisë Civile Civicus për Shqipërinë. (2010), faqe 19.

Ndikimi i perceptuar, përfshin shkallën në të cilën shoqëria civile është në gjendje të ndikojë në arenën sociale dhe të politikave. Në Kosovë ky nivel është më i ulët prej gjitha dimensioneve tjera, me vetëm 31.8% ²¹, ndërsa në Shqipëri është dukshëm më i lartë, rezultati 50.2%.²² Mjedisi i jashtëm është dimension i fundit, dhe realisht mat mjedisin në të cilin shoqëria civile ekziston dhe zhvillohet. Rezultati i përgjithshëm i mjedisit të jashtëm në Kosovë është me një përqindje prej 51.3,²³ kurse në Shqipëri 59.8%, një nga rezultatet më të larta në krahasim me dimensionet tjera.²⁴

5. Konkluzionet

Duke u bazuar në te tria raportet profesionale, shoqëritë civile në Kosovë dhe Shqipëri, pothuajse ballafaqohen me të njëjtat sfida. Për këtë arsye mund të vijmë dhe në ca përfundime të njëjta. Shoqëritë civile kosovare dhe shqiptare, duket se janë larg detyrës së tyre si kundër balancues i shtetit. Një pjesë e konsiderueshme e fajit, u takon vetë autoriteteve shtetërore të të dyja vendeve, të cilat në njërin anë po e anashkalojnë sektorin e shoqërisë civile, e në anën tjetër thirren si administratorë të demokracisë. Si rrjedhojë e kësaj ndikimi i tyre në proceset politike është i paefektshëm. Mirëpo, ndikimi i shoqërisë civile në proceset sociale dhe politike ka rezultuar të jetë më i ulët në Kosovë në raport me Shqipërinë. Megjithatë, pjesa më e fuqishme e organizatave të shoqërisë civile të të dyja shteteve mbetet kapaciteti i tyre organizativ, i cili sidomos në Kosovë është tejet solid.

Po ashtu, mungesa e njohurive të qytetarëve për rolin të cilin e ka një shoqëri civile në demokraci, bënë që angazhimi qytetar si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë të jetë në nivel të ulët. Prandaj, organizatat e shoqërisë civile nuk duhet vetëm të thirren në emër të qytetarëve, por duhet të jenë dhe më afër tyre, duke i përfaqësuar denjësisht interesat e tyre qytetare. Në fund të fundit, një shoqëri civile mund të forcohet vetëm nëse ka mjaft individë guximtarë, të cilët e kuptojnë se çka është ajo të cilën e dëshirojnë dhe kanë shkathtësi dhe këmbëngulësi politike të përpiqen për ta realizuar atë.

²¹ Raporti Analitik i Kosovës i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus. (2011), faqe 36.

²² Raporti Analitik Kombëtar i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus për Shqipërinë. (2010), faqe 22.

²³ Raporti Analitik i Kosovës i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus. (2011), faqe 41.

²⁴ Raporti Analitik Kombëtar i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus për Shqipërinë. (2010), faqe 25.

Bibliografia:

Gellner, Ernest. (2002) Konditat e Lirisë: shoqëria civile dhe rivalet e saj. Pejë: Dukagjini.

Clark, John D. (2003) Worlds Apart: Civil Society and the Battle for Ethical Globalization. USA: Kumarian Press.

Diamond, Larry. (1997) Civil Society and the Development of Democracy. Estudio/Working Paper.

Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC në Shqipëri, shih:

[:http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/ALB.pdf](http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/ALB.pdf)

Indeksi i qëndrueshmërisë 2012 së OSHC për Kosovën, shih:

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CS-KM.pdf>

Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2011, shih:

http://www.shqiptariitalise.com/images/al_rapport_2011_en.pdf

Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2011, shih:

http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf

Raporti Analitik i Kosovës (2011) i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus, shih:

http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/KCSF_CIVICUS_ISHC_Raporti_Analitik_per_Kosove.pdf

Raporti Analitik Kombëtar (2010) i Indeksit të Shoqërisë Civile të Civicus për Shqipërinë, shih:

http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/csi_albania_acr_alb.pdf